

lexime ballkanike
p o e z i

seria: Letërsi bashkëkohore nga Ballkani
konceptuar dhe përzgjedhur nga Arian Leka

Nikola Madzirov | *Gur i zhvendosur*

Titulli i originalit: ППЕМЕСТЕХ КАМЕХ

copyright© Nikola Madzirov

MAGOR, 2007, 2009

© copyright of the translation: S. Fischer Foundation by order of
TRADUKI

copyright© i botimit shqip POETEKА

e cila ruan të drejtën e shpërndarjes dhe promovimit në të gjithë
hapësirën shqipfolëse.

ISBN: 978-99956-29-99-1

Redaktor: Silvana Leka

Realizimi grafik: Akilon Stërmasi

Botimi i kësaj vepre u mbështet nga TRADUKI, një rrjet ndërkombëtar, të cilit i përkasin Ministria Federale për Çështje europiane e ndërkombëtare e Republikës së Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale Gjermane, Fondacioni kulturor zviceran Pro Helvetia, KulturKontakt Austria, Instituti Goethe, Fondacioni S. Fischer, Agjencia sllovene e Librit JAK dhe Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë.

traduki 

NIKOLA MADZIROV

GUR I ZHVENDOSUR

Përktheu nga maqedonishtja: Milena Selimi



botimet poeteka

дом

Живеев на крајот од градот
како умно светло на кое никој
не му ја менува светлината.

Пајажината ги врнеше зрвките заerno,
гојбата нашите светни златки.

Во предградите на невестини соизградени камења
го крие влчанинот ме
сипувајќи го од сокој.

Летонојно го оживував градот
брајанјич се како бела мис
секој се вриа на предкорничов цвел.
Беше мир кога го напукав голом:

Гризнаојќо јабоко не беше биселнево,
на бисмојо својше марија со старе напукав сета куја.

Кон шлвките дрисорт од рајатје се злечнам
и дог мене Гризничу се лебав
како снет мис не знае дали на земјабр
чим на воздухот Гриваја.

Илаурић

Hijet po na ikin

Një ditë do të takohemi
si anije letre dhe
bostan që ftohet në lumë.
Shqetësimi i botës do të jetë
me ne. Me pëllëmbë diellin
do ta errësojmë dhe me fener
do të afrohemi.

Një ditë era
nuk do ta ndryshojë drejtimin.
Mështekna gjethe do të dërgojë
në këpucët tona tek pragu.
Ujqërit do të nisen
pas dliresisë sonë.
Fluturat do të lenë pluhurin
në fytyrat tona.

Një plakë çdo mëngjes
do të rrëfejë për ne në sallën e pritjes.
Dhe kjo që po them
tashmë është thënë: presim erën
si dy flamuj në kalim kufiri.

Një ditë të gjitha hijet
do të na ikin.

Kur dikush largohet gjithçka që është krijuar kthehet

Për Marjan K.

Nga përçafimi tek qoshja do të kuptosh
se dikush diku po ikën. Gjithmonë është kështu.
Jetoj mes dy të vërtetash
si neoni që dridhet
në korridor të zbrazët. Zemra ime mbledh
gjithmonë e më shumë njerëz, sepse ata nuk janë më.
Kështu është gjithmonë. Çerekun e zgjimit
e humbasim në drithërima. Gjërat i harrojmë
ende pa i humbur –
Fletoren e bukurshkrimit, për shembull.
Asgjë nuk është e re. Ndenjësja në autobus
është gjithmonë e ngrohtë.
Fjalët e fundit zhvendosen
si kova të anuara në një zjarr të zakonshëm vere.
Nesër e njëjta gjë përsëri –
fytyra përpara se të zhduket nga fotografia
në fillim do humbasë rrudhat. Kur dikush largohet,
gjithçka që është krijuar kthehet.

Nuk di

Të largëta janë të gjitha shtëpitë që shoh në ëndërr,
i largët zëri i nënës që më thërret
për darkë, ndërsa unë vrapoj drejt fushave me grurë.

Të largët jemi ne si topi që humbet golin
dhe fluturon drejt qiellit, të gjallë jemi
si termometëri që është i saktë vetëm kur
e shohim.

Realiteti i largët për çdo ditë më pyet
si udhëtar i panjohur që më zgjon në mes të rrugës
me pyetjen "Ky është autobusi?".
dhe unë i them "Po", por mendoj "Nuk di",
nuk di ku janë qytetet e gjyshërve të tu
që duan të largojnë të gjitha sëmundjet e zbuluara
dhe ilaçet që përmbajnë durim.

Ëndërroj shtëpinë në malin e ëndrrave,
prej nga të shikoj si valët e detit krijojnë
kardiogramën e rënieve dhe dashurive tona,
si njerëzit besojnë, për të mos u mbytur
dhe ecin për të mos u harruar.

Të largëta janë të gjitha kasollet ku fshiheshim nga shiu
dhe nga dhembja e sorkadheve që vdisnin në sytë e gujetarëve,
të cilët ishin më shumë të vetmuar se sa të uritur.

Çasti i largët përditë më bën pyetjen
"A është kjo dritarja? A është kjo jeta?" dhe unë i përgjigjem
"Po", dhe në fakt "Nuk di", nuk di kur
zogjtë do të flasin dhe të mos thonë " Qiell".

Pas nesh

Një ditë dikush do t'i palos batanijet tona
dhe do t'i dërgojë në pastrim kimik
për të hequr prej tyre edhe kokrrën e fundit të kripës,
do të hapë letrat tona dhe do t'i rreshtojë sipas datave
jo sipas leximit.

Një ditë dikush do të lëvizë mobiljet e dhomës
si të ishin figura shahu në fillim të lojës,
do të hapë kutinë e vjetër të këpucëve
ku ruajmë kopsat e këputura të pizhamave,
bateritë e paharxhuara dhe urinë.

Një ditë do të na kthehet dhimbja e shpinës
nga pesha e çelësave të hoteleve dhe
dyshimi i recepsionistit që na zgjaste telekomandën.

Keqardhjet e huaja do të nisen pas nesh
si hëna pas fëmijës së humbur.

Akrepa ore

Trashëgo fëmijërinë nga foto–albumi.
Shpërngul heshtjen
që përhapet dhe mblidhet si
tufë zogjsh në fluturim.
Topin e borës ruaje
në pëllëmbën e dorës
dhe pikat e tij që rrjedhin
në vijën e jetës.
Thuaje lutjen
me buzë të mbledhur:
fjalët janë farë që bien në saks.

Heshtja mësohet në barkun e nënës.

Provo të lindësh
si akrep i madh pas mesnatë
dhe sekondat papritur do të të arrijnë.

Shumë gjëra ndodhën

Shumë gjëra ndodhën
ndërsa Toka rrotullohej mbi
gishtin e Zotit.

Telat u çliruan
nga largpërçuesit dhe tani
po lidhin dashuritë.
Pikat e oqeanit
padurim shtresoheshin mbi
muret e shpellave.
Petalet e luleve u ndanë
nga mineralet dhe u nisën
pas aromës.

Nga xhepi i pasmë u përhapën
fletushka nëpër dhomën tonë të tejdukshme
gjëra të parëndësishme që kurrë
nuk do t'i kishim bërë po të
mos i kishim të shkruara.

Qielli po hapet

Trashëgova një shtëpi të pashënuar,
disa fole të shkatërruara
dhe të çara në mur si damarë
dashnori të eksituar.
Në to fle era
dhe fjalët e mungesave
të kondensuara. Është verë
dhe kundërmon erë trumëz e shkelur.
Murgjit po përfundojnë tespohet,
qielli hapet, për të sjell një rrymë ere
në shpirtrat tanë.
Pemët janë të gjelbra, ne – të padukshëm
dhe vetëm kështu mund të shihen
fëmijët tanë të palindur dhe nata
që ëngjëjt i bën
akoma më të pastër.

E thëna po na ndjek

U dhamë emra
bimëve të egra
pas ndërtesave të pambaruara,
i emërtuam të gjithë monumentet
e robëruesve tanë.
Fëmijët i pagëzuan
me nofka dashurie
nxjerrë nga letrat
njëherë të lexuara.

Pastaj fshehtas zbërthenim nënshkrimet
në fund të recetave
për sëmundje të pashëruara,
me dylbi po afronim pëllëmbët
në ndarje, mbështetur
mbi dritaret.

Fjalët i linim
poshtë gurëve me hije groposur
në kodrën, e cila ruan jehonën
e paraardhësve të pashkruar
në trungun e familjes.

Ajo që thamë pa dëshmitarë
akoma për shumë kohë do të na ndjekë.

Dimrat u shtuan brenda nesh
pa qenë të kujtuar.

Fluturim

Mjegulla varet mbi qytet
si koka e ulur e Shën Mërisë
nga afresk i largët.

Antenat satelitore bisedojnë
me ëngjëjt
si do të jetë koha nesër:
e kthjellët, e parrezikshme, e rëndësishme
si kalendar me
data të kuqe.

Por sapo nata të bashkojë
hijet me murin,
ti do të ikësh drejt degëve
si zog i rrallë
nga e pasmja e banknotës.

Kur koha do të mbarojë

Mbetje nga një shekull tjetër ne jemi.

Prandaj nuk mundem për
shtëpi të flas, as
për vdekje dhe dhimbje të përgatitura.

Asnjë rrëmihës pa leje deri më sot
nuk i ka zbuluar muret midis nesh,
as të ftohtin në eshtrat
nga mbetjet e gjithë shekujve.

Kur koha do të mbarojë, për
të vërtetën do bisedojmë aherë
dhe në ballin tonë xixëllonjat
do të formojnë yjësi.

Asnjë profet i rremë
thyerje gotash nuk ka parashikuar, as
prekje dy pëllëmbësh – dy
të vërtetash të mëdha që uj' të pastër
rrjedhin.

Mbetje nga një shekull tjetër ne jemi.
Si ujçër, para nishanit të përjetshmit faj,
në peizazhet e vetmisë së zbutur
zhytemi.

Hija e botës mbi zemrën më kalon*

Unë s'kam kurajon e gurit të zhvendosur
do më gjesh të shtrirë në stolin e lagur
jashtë gjithë kampeve dhe arenave.

Bosh jam si një qese
e mbushur me ajër.

Pëllëmbëlarguar dhe gishtabashkuar
çati po tregoj.

Mungesa ime është ndihmesë për të gjitha
historitë e rrëfyera e mosarritje të paramenduara.

Kam një zemër të shpuar me brinjë.
Në gjak më lëvizin copa qelqesh
dhe ca re fshehur pas ruazash të bardha.

Unaza në dorën time nuk ka hije të sajën
dhe ngjashmëri me diellin. Unë nuk kam guximin
e yllit të zhvendosur.

* Lucian Blaga filozof, poet dhe dramaturg rumun (shënim i përkthyesit)

Gjerat që duam t'i prekim

Asgjë nuk ekziston jashtë nesh:

liqenet artificiale avullojnë
në çastet kur jemi të etur
për heshtje, kur hithra po bëhet
bar shërues, ndërsa qytetet ua kthejnë
pluhurin varrezave më të afërta.

Cjithë lulet bardh' e zi të letrës së mureve
në shtëpitë që kemi braktisur,
mbinë në historitë e pavlera,
në çastet kur fjalët tona
bëhen trashëgimi e palënë;
ndërsa gjërat që duam ti prekim –
prani e dikujt.

Si këpucë e panjohur jemi,
shpërndarë nëpër ikjet e qenve endacakë,
mbahemi në përçafim,
si kabllot lidhur mes tullash
në shtëpi pabanim.

Prej kohësh tashmë nuk ekziston asgjë
jashtë nesh:

ndonjëherë diell, dritë apo ëngjëll
njëri–tjetrin e quajmë.

Zbulim

Prej kohësh nuk i përkas askushit
si monedhë e rënë nga cepi i ikonës së vjetër.
Jam i shpërndarë mes trashëgimish dhe amanetesh të rrepta
pas grilave fatesh të dhëna.
Historia është kufiri i parë që duhet ta kaloj,
pres zërin të ndarë nga bashkëtingëllimi i bindjes
për lashtësinë time të më njoftojë.
Si monument bronzi nën sheshin me yje jam unë,
mbi të cilin zogjtë himnet e shpresës këndojnë,
si një pendë në lëvoren e vezës e shoh veten,
që flet për largimin e parakohshëm dhe
ardhjen e jetës së re.
Shtëpia ime përditë
nën tendën e botës fshehtas ndryshon,
vetëm fëmijëria është si mjalt
që nuk lejon gjurmë të huaj brenda vetes.

Ishte pranverë

Ishte pranverë kur pushtuesi
i dogji tapitë e pronës ku gjuanim zogj,
insekte laroshe, flutura që akoma
janë në librat e vjetër shkollorë të biologjisë.

Shumë gjëra prej asaj kohe ndryshuan
botën, shumë gjëra bota ndryshoi brenda nesh.